



РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА
REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

Бр./Nr _____

_____г./в.



Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 nga Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë " Nr. 12/2019) neni 40 paragrafi 3 nga Rregullorja për punë të Komisionit Shtetërorë për Parandalimin e Korrupsionit, duke vepruar sipas denoncimit të parashtruar nga parashtrues i njohur KSHPK (në tekstin e mëtejshëm) në seancën e74-të, të mbajtur më 05.09.2022, morri vendimin vijues:

VENDIM

Procedura sipas lëndës me numër 12-3565 / 1 nga data 14.10.2020,, NDËRPRËTET. KSHPK-ja përcaktoi se autoriteti tjetër kompetent është duke vepruar ndaj lëndës. Lënda me numër 12-3565 të vitit 2020 të mbyllet dhe të arkivohet .

Vendimi i KSHPK-së, në formë të depersonalizuar, të publikohet në ueb - faqen e KSHPK-së brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e vendimarrjes.

Arsyetim

Lënda me numër 12-3565/1 të datës 14.10.2020 është formuar në bazë të denoncimit të marrë nga ///. Pretendimet e paraqitura në denoncim i referohen dyshimeve për sjellje të pakujdesshme dhe keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe kompetencave të zyrtarëve, të punësuar në Ministrinë e Financave të RMV - Komisioni për Denacionalizim /// dhe /// me seli në Komunë ///, lidhur me denacionalizimin e pronës, në territorin e Komunës ///. Denoncimi është plotësuar radhazi më 02.10.2020 dhe më 13.10.2020. Nga KSHPK-ja kërkohet ta rishqyrtojë këtë rast në përputhje me kompetencat e saj ligjore. Në shtojcë të denoncimit, u dorëzuan edhe prova.

Pas këqyrjes së përmbajtjes së denoncimit dhe provave të dorëzuara, KSHPK-ja kërkoi veprime kompetente nga MPB-ja e RMV-së, Komisioni i lartpërmendur dhe Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsion - Shkup, për të cilën në mënyr të vazhdueshme është vepruar. Pas shqyrtimit të parashtrësive, KSHPK-ja konstatoi se në këtë rast organ kompetent që vepron sipas pretendimeve nga kërkesa është Prokuroria Themelore Publike në Shkup, për të cilën Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së ka dërguar njoftim me datë /// . Po ashtu, Prokuroria Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit - Shkup lëndën e parashtruar me /// në vitin///, e formuar me rastin e kallëzimit penal të parashtruar nga parashtruesit, ia ka përcjellë Prokurorisë Themelore Publike - Shkup për veprime të mëtutjeshme, nga ku edhe ka dalë se organi tjetër kompetent tashmë është duke ndërmarrë veprime për këtë rast, për shkak të të cilit ka rënë baza e KSHPK-së për veprime të mëtutjeshme në këtë rastin konkret.



Sipas sa më sipër, KSHPK-ja vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

Dorëzuar deri te:
Parashtruesi i denoncimit

Përgaditi: Mr D. D.
Miratoi: G.T.

KOMISIONI SHTETËRORË
PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
KRYETARE,
Biljana Ivanovska

